

BENET BECI



Datëlindja: 25.01.1965

Vendlindja: Tiranë

Email: Benet.Beci@parlament.al

Jetëshkrimi:

Ka lindur në Tiranë, më 25 janar 1965. Benet Beci ka kryer studimet universitare në Fakultetin e Ekonomisë në vitin 1987, master në Administrim Biznesi me temë mbi sistemin bankar në vitin 2003 dhe doktoraturën në vitin 2015 me një temë mbi zhvillimin rajonal.

Gjatë karrierës së tij, Benet Beci i janë besuar detyra të rëndësishme sidomos në sistemin bankar ku ka pasur disa pozicione, nga të cilat më i spikaturi ka qenë ai i anëtarit të Këshillit Mbikqyrës të Bankës së Shqipërisë. Gjithashtu ka një përvojë të gjerë edhe në menaxhim financiar në institucione të Financimit Rural.

Detyra më e rëndësishme ka qenë ajo e drejtorit të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, një institucion publik që implementon projekte zhvillimi në nivel lokal dhe kombëtar. Ai e ka mbajtur këtë post që prej vitit 2005 deri më 2019. Ai ka mbajtur edhe detyrën e Administratorit në Korporatën Elektroenergjitike Shqiptare.

Ai ka kryer edhe një sërë specializimesh të tjera brenda dhe jashtë vendit, kryesisht në sistemin bankar dhe atë të mikrofinancës, analizës financiare e menaxhimit të riskut, por edhe mbi partneritetet publiko-private dhe inovacionet në qeverisje.